

SMARTWORK SH.P.K

PASQYRAT FINANCIARE

**PER PERIUDHEN NGA DATA E THEMELIMIT 28 KORRIK 2017
DERI ME 31 DHJETOR 2017**

PERMBAJTJA:	FAQJA
PASQYRAT FINANCIARE	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3-4
PASQYRA E PERFORMANCES DHE TE ARDHURAVE TE TJERA GJITHEPERFSHIRESE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO	6
PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE	7
SHENIMET SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE	8-18

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

AKTIVET	Shenime	Me 31 dhjetor 2017
Aktivet afatshkurtra		
Aktivet monetare	4	105,881
<i>Banka</i>		<i>105,881</i>
Investime		-
Te drejta te arketueshme		17,066,827
<i>Nga aktiviteti i shfrytezimit</i>	5	<i>13,215,230</i>
<i>Te tjera</i>	6	<i>3,851,597</i>
Inventaret		-
Shpenzime te shtyra	7	622,713
Te arketueshme nga te ardhurat e konstatuara		-
Totali aktiveve afatshkurtra		17,795,421
Aktivet afatgjata		
Aktive financiare		-
Aktivet materiale	8	23,200,883
<i>Te tjera instalime dhe pajisje</i>		<i>23,200,883</i>
Aktivet biologjike		-
Aktive jo materiale		-
Aktive tatimore te shtyra		-
Totali aktiveve afatgjata		23,200,883
Totali i aktivitetit		40,996,304

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 8 deri ne 18, te cilat jane pjese perberese e Pasqyrave Financiare.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR


DETYRIMET DHE KAPITALI	Shenime	Me 31 dhjetor 2017
Detyrime afatshkurtra		33,719,595
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i>	9	24,423,930
<i>Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore dhe shendetesore</i>	10	1,256,684
<i>Te pagueshme per detyrimet tatimore</i>	11	487,421
<i>Financime te tjera</i>	12	7,551,560
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara	13	4,103,657
Te ardhura te shtyra		-
Provizione		-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		37,823,252
Detyrime afatgjata		-
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		-
Te ardhura te shtyra		-
Provizione		-
Detyrime tatimore te shtyra		-
Totali i detyrimeve afatgjata		-
Totali i detyrimeve		37,823,252
Kapitali		13,376,100
Fitimi i pashperndare		-
Humbja e vitit		(10,203,048)
Totali i kapitalit		3,173,052
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		40,996,304

Keto Pasqyra Financiare u miratuan dhe u nenshkruan nga Administratori i shoqerise Smartwork sh.p.k me date 30.03.2018.

Administratori i Shoqerise

Andrea Ruscica

GJERGJ DORO
 NE PROKURE



Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 8 deri ne 18, te cilat jane pjese perberese e Pasqyrave Financiare.

Smartwork sh.p.k.

Pasqyra e performances dhe te ardhurave te tjera gjithëpërshiresë per periudhen nga data e themelimit 28 korrik 2017 deri me 31 dhjetor 2017

(shumat ne LEK)

**PASQYRA E PERFORMANCES DHE TE ARDHURAVE TE TJERA
GJITHEPËRSHIRESE**

	Shenime	Per periudhen nga data e themelimit 28 korrik 2017 deri me 31 dhjetor 2017
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	14	17,510,741
Ndryshimi ne inventarin e produkteve te gatshme dhe prodhimet ne proces		-
Puna e kryer nga njesia ekonomike dhe e kapitalizuar		-
Te ardhura te tjera te shfrytezimit		2,188,377
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		-
Shpenzime te personelit		(17,895,220)
<i>Paga dhe shperblime</i>		<i>(15,623,962)</i>
<i>Shpenzime te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore</i>		<i>(2,271,258)</i>
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale		-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	(575,818)
Shpenzime te tjera shfrytezimi	15	(11,495,633)
Te ardhura te tjera	16	64,505
<i>Interesa te arketueshme dhe te ardhura te tjera te ngjashme</i>		<i>64,505</i>
Zhvleresimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra		-
Shpenzime financiare		-
Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesemarrjet		-
Humbja para tatimit		(10,203,048)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	17	-
Humbja e vitit		(10,203,048)
Te ardhura te tjera gjithëpërshiresë per vitin		-
Totali i humbjeve gjithëpërshiresë per vitin		(10,203,048)

Pasqyra e performances dhe te ardhurave te tjera gjithëpërshiresë duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 8 deri ne 18, te cilat jane pjese perberese e Pasqyrave Financiare.

Smartwork sh.p.k.

Pasqyra e ndryshimeve ne kapitalin neto per periudhen nga data e themelimit 28 korrik 2017 deri me 31 dhjetor 2017
(shumat ne LEK)

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO

	Kapitali i nenshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivleresimi	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva te tjera	Fitimet e Pashperndara	Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar me 28 korrik 2017	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Emetim i kapitalit te nenshkruar	13,376,100								13,376,100
Humbja e vitit	-	-	-	-	-	-	-	(10,203,048)	(10,203,048)
Pozicioni financiar me 31 dhjetor 2017	13,376,100	-	-	-	-	-	-	(10,203,048)	3,173,052

Pasqyra e ndryshimeve ne kapitalin neto duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 8 deri ne 18, te cilat jane pjese perberese e Pasqyrave Financiare.

Smartwork sh.p.k.

Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare per periudhen nga data e themelimit 28 korrik 2017 deri me 31 dhjetor 2017

(shumat ne LEK)

PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE

	Shenime	Per periudhen nga data e themelimit 28 korrik 2017 deri me 31 dhjetor 2017
Fluksi i mjeteve monetare gjeneruar nga aktiviteti i shfrytezimit		
Fitimi perpara tatimit	17	(10,203,048)
Rregullimet per shpenzimet jomonetare:		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	575,818
Rritje ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera	5/6	(17,066,827)
Rritje ne detyrimet e pagueshme	9/11/13	29,015,008
Rritje ne detyrime per punonjesit	10	1,256,684
Renie ne shpenzime te shtyra	7	(622,713)
Mjete monetare gjeneruar nga aktivitet e shfrytezimit		2,954,922
Fluksi i mjeteve monetare gjeneruar nga aktiviteti i investimit		
Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale	8	(23,776,701)
Mjete monetare neto perdorur ne aktivitetin e investimit		(23,776,701)
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti i financimit		
Arketime nga emetimi i kapitalit aksionar		13,376,100
Hua te arketuara	12	7,551,560
Mjete monetare neto gjeneruar nga aktiviteti i financimit		20,927,660
Renie neto ne mjete monetare dhe ekuivalente		105,881
Mjete monetare dhe ekuivalente me 28 korrik 2017		-
<i>Efekti i luhatjeve te kursit te kembimit te mjeteve monetare</i>		<i>-</i>
Mjete monetare dhe ekuivalente me 31 dhjetor 2017		105,881

Pasqyra e fluksit te mjeteve ,monetare duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 8 deri ne 18, te cilat jane pjese perberese e Pasqyrave Financiare.

Smartwork sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per periudhen nga data e themelimit 28 korrik 2017 deri me 31 dhjetor 2017

(shumat ne LEK, pervecse ku shprehet ndryshe)

1. Informacion i Pergjithshem

Smartwork sh.p.k (ne vijim referuar si “Shoqeria”), eshte regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me date 28 korrik 2017 me numer NIPT L71928020R dhe me adrese ne Rrugen e Elbasanit, nr. 36, Tirane. Administratori i Shoqerise eshte shtetasi italian Z. Andrea Ruscica.

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte projektimi, realizimi, manaxhimi dhe kontrolli i sistemeve informative dhe te programeve aplikative si dhe aktivitet informatik dhe telematik te kryer ne favor te te treteve, perpunimi i te dhenave per te tretet, realizimi i shitjes se produkteve editorial. Shoqeria mund te kryeje aktivite te tregtimit si me pakice ashtu dhe me shumice, me korrespondence dhe me rruge telematike te produkteve dhe sherbimeve per ndermarrje, profesioniste dhe private, per automatizimin e zyres dhe ne pergjithesi per informatizimin e te dhenave si dhe te aparaturave, sendeve te levizshme dhe paisjeve per zyra.

Me 31 dhjetor 2017 Shoqeria ka deklaruar 66 punemarres.

2. Bazat e Pergatitjes se Pasqyrave Financiare

2.1 Deklarata e pajtuesmerise

Pasqyrat financiare jane perpiluar ne perputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara (SKK) dhe Ligjin nr. 9228, date 29 prill 2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

2.3 Biznesi ne vijimesi

Pasqyrat Financiare te Shoqerise pergatiten mbi supozimin e biznesit ne vijimesi, i cili merr parasysh se Shoqeria do te vazhdoje ekzistencen e aktivitetit te saj per te pakten 12 muaj pas dates se ketyre pasqyrave financiare.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare jane prezantuar ne Lek, e cila eshte edhe monedha funksionale e Shoqerise.

2.5 Vleresime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kerkon qe menaxhimi i Shoqerise te kryeje vleresime dhe supozime qe ndikojne shumat e raportuara te aktiveve, detyrimeve te kushtezuara ne daten e pasqyres se pozicionit financiar, si dhe te ardhurave dhe shpenzimeve te krijuara ne periudhen kontabel.

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te Shoqerise dhe shumave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje nga keto vleresime.

Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme dhe bazohen ne eksperiencen e meparshme dhe faktore te tjere duke perfshire pritshmerine per ngjarjet e ardhshme te cilat besohen te jene te arsyeshme ne rrethanat aktuale. Manaxhimi kryen vleresime dhe gjykime ne lidhje me te ardhmen.

Vleresimet kontabel qe rezultojne sipas perkufizimit, jo gjithmone do te barazohen me rezultatet aktuale. Vleresimet dhe supozimet qe kane risk te rendesishem per te shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, te vlerave te mbartura te aktiveve dhe detyrimeve jane pershkruar me poshte.

2. Bazat e Pergatitjes se Pasqyrave Financiare (vazhdim)

2.6 Zhvleresimi i te drejtave te arketueshme

Zhvleresimi i te drejtave te arketueshme bazohet ne humbjet e vleresuara, te cilat rezultojne nga pamundesia per te paguar detyrimet. Keto vleresime bazohen ne moshen e te drejtave te arketueshme dhe eksperiencen e meparshme ne c'registrimin, vleresimin e aftesise paguese te klienteve, si dhe ndryshimet e fundit dhe te pritshme te termave te pageses. Manaxhimi vlereson ne fund te cdo periudhe ne rast se ka nevojte per zhvleresim te tyre.

2.7 Provizionet

Provizionet ne pergjithesi kerkojne nje nivel te larte gjykimi, vecanerisht ne rastet e ceshtjeve gjyqesore. Shoqeria vlereson mundesine e krijimit te detyrimit aktual si rrjedhoje e nje ngjarje te shkuar, ne rast se mundesia e ndodhjes vleresohet te jete me shume se 50%. Ne te tilla raste Shoqeria provizionon vleren e detyrimit e cila mund te matet me besueshmeri. Per shkak te nivelit te larte te pasigurise, ne disa raste mund te ndodhe qe vleresimi mund te mos jete ne te njejten linje me rezultatin e ceshtjes. Manaxhimi vlereson ne fund te cdo periudhe ne rast se ka nevojte per krijimin e provizioneve.

3. Politikat kontabel

Politikat kontabel te meposhtme jane aplikuar ne menyre konsistente ne te gjitha periudhat e paraqitura ne pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e raportimit. Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jo monetare ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehin ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlere e drejte. Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Kursi i kembimit i monedhave te huaja me 31 dhjetor 2017 eshte detajuar si me poshte:

Kursi i kembimit	31 dhjetor 2017
EUR/LEK	132.95

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare perbehen nga mjetet monetare, nje instrument borxhi (si llogari, deftese ose hua e arketueshme ose e pagueshme) qe plotesojne kushtet, hua te marra ose te dhena dhe detyrime financiare. Instrumentat financiare njihen fillimisht me kosto plus cdo kosto transaksioni qe lidhet me to. Kostoja eshte: (a) vlere e drejte e parase ose e ekuivalenteve te saj te paguara ose vlere e drejte e shperblimeve te dhena per te blere nje aktiv ne kohen e blerjes ose te ndertimit te tij; (b) shuma e parase ose e ekuivalenteve te saj te arketuara ose vlere e drejte e shperblimeve te marra per te shitur nje detyrim ne kohen e shitjes ose likuidimit te tij.

Nje instrument financiar njihet nese Shoqeria behet pjese e kushteve kontraktuale te instrumentit. Aktivitetet financiare c'registruohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te Shoqerise mbi flukset e parase se aktivitetet

3 Politikat Kontabel (vazhdim)

3.2 Instrumenta financiare (vazhdim)

financiar ose kur Shoqeria transferon aktivin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe perfitimet thelbesore te aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen njesia ekonomike angazhohet te bleje apo te shese aktivin. Detyrimet financiare c'registroheshen nese detyrimet kontraktuale te Shoqerise skadojne, shfuqizohen ose anulohen.

Aktivet monetare

Aktivet monetare perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne banke. Per qellimin e pasqyres se fluksit te parase, aktivet monetare perfshijne depozita me afat me nje maturim prej tre muajsh ose me pak qe nga data e fillimit.

Te drejtat e arketueshme

Te drejtat e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provigjioni per zhvleresimin e aktiveve te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se Shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshtiresite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues qe te drejtat e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provizionit llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen e interesit efektiv.

Llogari te pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me kosto dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Tituj te huadhenies dhe huamarrjes

Tituj te huadhenies dhe huamarrjes njihen me kosto minus zhvleresim, pa perfshire koston e transakcioneve. Humbja nga zhvleresimi eshte diferenca mes vleres kontabel te aktivitetit dhe vleresimit me te mire qe njesia mund te marre per aktivin nese ai do te shitej ne daten e raportimit. Interesat e njohura ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve jane perllogaritur mbi bazen e interesit nominal.

3.3 Inventaret

Inventaret njihet fillimisht me kosto historike dhe ne vijim vleresohet me vleren me te vogel mes koston dhe cmimit te realizuar te shitjes i zvogeluar me shpenzimet e ndryshueshme te shitjes. Kostoja e inventarit perfshin koston e te gjitha materialeve te lidhura drejtperdrejte me prodhimin dhe koston e shnderrimit te ketyre materialeve ne produkte perfundimtare. Kur inventaret konsumohen, vlera e tyre e mbetur njihet si shpenzim ne periudhen ne te cilen e ardhura perkatese njihet. Shuma e renies ne vlere te inventareve deri ne cmimin e realizuar te shitjes si dhe te gjitha humbjet nga inventaret njihen si shpenzime ne periudhen ne te cilen renia ne vlere apo humbja ndodh.

3.4 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve te vete-ndertuara perfshin koston e materialeve dhe punes direkte, cdo kosto tjeter te lidhur drejtperdrejt me sjelljen e aktivitetit ne gjendje pune per qellimin e synuar te perdorimit, si dhe kosto cmontimit, heqjes se pjeseve dhe sjelljes ne gjendjen e meparshme te vendodhjes se aktivitetit. Shpenzimet kapitale te aktiveve te bera gjate ndertimit kapitalizohen ne "Ndertim ne proces" dhe transferohen ne

3 Politikat Kontabel (vazhdim)

3.4 Aktive afatgjata material (vazhdim)

kategorine perkatese te aktivitet kur perfundon ndertimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi perkates sipas kategorise. Ne rastet kur pjese te nje aktivi afatgjate material kane jetegjatesi te ndryshme, ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponentet me te medhenj) te aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mepashme

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundshme qe Shoqeria do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdorimi i pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke perdorur metoden e vleres se mbetur te amortizimit mbi jeten e vleresuar te cdo pjese te aktivitet afatgjate material duke filluar nga dita e pare e muajit qe pason muajin e blerjes. Aktivitet e marra me qira amortizohen duke marre per baze periudhen me te shkurter midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivitet.

Metodat dhe normat e amortizimit per vitin aktual jane si me poshte:

Kategoria e aktiveve	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Toka	Nuk amortizohet	-
Ndertesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri e pajisje	Vlere e mbetur	20%
Pajisje zyre	Vlere e mbetur	20%
Pajisje kompjuterike	Vlere e mbetur	25%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne cdo date raportimi. Nje ze i aktiveve afatgjata materiale c' regjistrohet kur ai nxirret jashte perdorimit apo atehere kur nuk priten me perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi apo nxjerrja jashte perdorimit. Fitimi dhe humbjet ne rastin e nxjerrjes jashte perdorimit te aktiveve afatgjata materiale, percaktohen sipas shumes se tyre te mbetur dhe merren paraysh ne nxjerrjen e rezultatit operativ te vitit.

3.5 Te ardhurat

Te ardhurat njihen atehere kur eshte e mundshme qe Shoqeria te kete perfitime ekonomike ne te ardhmen dhe keto perfitime mund te maten me besueshmeri. Te ardhurat maten me vleren e drejte te shumes se arketuar ose te arketueshme dhe ne vleresimin e vleres se drejte merren ne konsiderate edhe zbritjet e mundshme qe i behen cmimit te transaksionit

3.6 Te ardhurat e tjera te shfrytezimit

Te ardhura te tjera te shfrytezimit perftohesh jashte rrjedhes normale te veprimtarise ekonomike, duke perfshire fitimet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale ndryshimet ne llogarite/kerkesat e arketueshme dhe detyrimet per t'u paguar furnitoreve (nese rezulton nje humbje neto, ajo njihet ne zerin "Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit").

3 Politikat Kontabel (vazhdim)

3.7 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhura interesi nga llogarite bankare dhe fitime nga kursi i kembimit qe njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Te ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e te drejtave te konstatuara duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare perfshijne shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i kembimit, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare te mbajtura me vlere te drejte nepermjet llogarise fitim/humbje dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me metoden e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga kurset e kembimit raportohen ne baze neto.

3.8 Shpenzime te personelit

Kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore

Njesia ekonomike paguan vetem kontributet per sigurimet shoqerore te detyrueshme qe percaktojne perfitimet e punonjesve qe dalin ne pension. Autoritetet Fiskale jane pergjegjese per percaktimin e limitit ligjor te vendosur per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani kontributesh pensioni te percaktuar. Kontributet e Shoqerise ndaj planit te pensioneve ngarkohen ne fitim ose humbje kur ato ndodhin. Shoqeria ka deklaruar, perllogaritur dhe paguar kontribute te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore ne perputhje me Ligjin nr. 9136, date 11.09.2003 "Per mbledhjen e detyrueshme te kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore", si dhe Udhezimit perkates nr. 26, date 16.04.2009, mesatarisht per 66 punonjes gjate vitit 2017.

3.9 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtperdrejte ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i vitit eshte tatimi i pritshem per t'u paguar mbi te ardhurat e tatueshme te vitit, duke perdorur normat tatimore te miratuara gjate vitit.

Tatimi mbi fitimin llogaritet duke u bazuar ne ligjin ne fuqi per "Tatimin mbi fitimin". Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin te gjitha barren per vitin korrent. Norma e tatimit mbi fitimin per vitin financiar 2017 eshte 15 %.

3.10 Transaksionet me palet e lidhur

Palet e lidhura percaktohen kur nje pale kontrollohet nga pala tjetere ose ka ndikim te rendesishem ne vendimet e biznesit apo vendimet financiare te pales tjetere. Per qellime te pasqyrave financiare, drejtimi i shoqerise dhe manaxhimi konsiderohen si pale te lidhura.

3.11 Provizionet

Nje provizion njihet nese, si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar Shoqeria ka nje detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund te vleresohet ne menyre te besueshme dhe do te kerkoje ne te ardhmen flukse dalese parash per shlyerjen e tij. Provizionet percaktohen duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te parase me nje norme skontimi para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per risqet qe lidhen me detyrimet ne fjale.

3.12 Aktivet dhe detyrimet e kushtezuara

Detyrimet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare. Ato paraqiten ne shenime te pasqyrave financiare per aq kohe qe mundesia per nje dalje te burimeve qe perfshijne perfitime ekonomike eshte e larget. Nje aktiv i kushtezuar nuk paraqitet ne pasqyrat financiare, por paraqitet ne shenime per sa kohe ekziston mundesia e hyrjes se perfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve te kushtezuara njihet si provizion, nese eshte e mundshme qe ngjarjet e ardhshme te konfirmojne qe nje detyrim ka lindur ne daten e pozicionit financiar dhe mund te behet nje vleresim i arsyeshem i shumes.

4. Aktivet monetare

Aktivete monetare me 31 dhjetor 2017 perbehen nga sa me poshte:

	Me 31 dhjetor 2017
Llogari rrjeshese ne monedhen Leke-Union Bank	89,957
Llogari rrjeshese ne monedhen Leke-nion Bank	15,924
Totali	105,881

5. Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit

Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit me 31 dhjetor 2017 perbehen nga sa me poshte:

	Me 31 dhjetor 2017
<i>Te arketueshme nga kliente:</i>	
Alterna S.r.l	7,474,316
Altea Up S.r.l	2,976,883
Altea Digital S.r.l	1,467,768
PLM Systems S.r.l	764,463
Altea 365 S.r.l	531,800
Totali	13,215,230

6. Te drejta te tjera te arketueshme

Te drejta te tjera te arketueshme me 31 dhjetor 2017 perbehen nga sa me poshte:

	Me 31 dhjetor 2017
Teprice kreditore te TVSH-se	3,247,174
Garanci	239,310
Paradhenie per te trete	238,410
Paradhenie per punonjesit	126,703
Totali	3,851,597

7. Shpenzime te shtyra

Shpenzime te shtyra me 31 dhjetor 2017 perbehen nga sa me poshte:

	Me 31 dhjetor 2017
Shpenzime te periudhave te ardhshme	622,713
Totali	622,713

Zeri "Shpenzime te shtyra" perfshin shpenzime interneti dhe sigurimi privat per punonjesit, fatura e te cilave eshte marre gjate vitit 2017, por sherbimi mbulon me shume se nje periudhe tatimore.

8. Aktive Materiale

Aktivitet materiale me 31 dhjetor 2017 perbehen nga sa me poshte:

	Te tjera instalime dhe pajisje	Kompjuterat dhe pajisje informatike	Pajisje te ndryshme zyre	Totali
Kosto				
Gjendja me 28 korrik 2017	-	-	-	-
Shtesa	1,455,646	19,057,192	3,263,863	23,776,701
Pakesime	-	-	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2017	1,455,646	19,057,192	3,263,863	23,776,701
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja me 28 korrik 2017	-	-	-	-
Amortizimi per periudhen	17,694	398,313	159,812	575,818
Pakesimet	-	-	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2017	17,694	398,313	159,812	575,818
Vlera kontabel neto me 31 dhjetor 2017	1,437,952	18,658,879	3,104,051	23,200,883

9. Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit

Llogari te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit me 31 dhjetor 2017 perbehen nga sa me poshte:

	Me 31 dhjetor 2017
ABS Sh.p.k	11,838,666
Altea S.p.a	6,031,144
Altea Up S.r.l	3,239,460
Deloitte Albania Sh.p.k	1,523,341
Intersig Sh.a	482,963
Union Travel Sh.p.k	366,408
PF Trade Tirana Sh.p.k	239,310
Sahhilba Sh.p.k	125,440
Alkilda Hysejri	116,508
Vodafone Albania Sh.a	91,389
Debitore te tjere	57,796
Speed Taxi Sh.p.k	53,652
Diplomat HY Sh.p.k	53,200
Valter Marashi	49,500
OSHEE Sh.a	40,235
Kamela Nacollari	33,790
Lajthiza Invest Sh.a	31,950
American Capital Sh.p.k	28,928
Digicom Sh.p.k	20,250
Totali	24,423,930

10. Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore dhe shendetesore

Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore e shendetesore me 31 dhjetor 2017 perbehen nga sa me poshte:

	Me 31 dhjetor 2017
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	1,254,953
Paga dhe shperblime	1,731
Totali	1,256,684

11. Te pagueshme per detyrimet tatimore

Te pagueshme per detyrimet tatimore me 31 dhjetor 2017 perbehen nga sa me poshte:

	Me 31 dhjetor 2017
Tatimi mbi te ardhurat personale	483,886
Tatimi ne burim	3,535
Totali	487,421

12. Financime te tjera

Financime te tjera me 31 dhjetor 2017 perbehen nga sa me poshte:

	Me 31 dhjetor 2017
Financime nepermjet huamarrjes	7,551,560
Totali	7,551,560

Shoqeria gjate vitit 2017 ka marre hua nga Z. Gjergji Robo per te financuar veprimtarine operationale sipas kontrates nenshkruar mes paleve.

13. Te pagueshme per shpenzime te konstatuara

Te pagueshme per shpenzime te konstatuara me 31 dhjetor 2017 perbehen nga sa me poshte:

	Me 31 dhjetor 2017
Furnitore per fatura te pamberritura	4,103,657
Totali	4,103,657

Ne llogarine "Te pagueshme per shpenzime te konstatuara" Shoqeria ka regjistruar shpenzime te kryera gjate muajit dhjetor te vitit 2017, faturat e te cilave jane marre gjate muajve te pare te vitit 2018.

14. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit

Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit per periudhen nga data e themelimit 28 korrik 2017 deri me 31 dhjetor 2017 perbehen nga sa me poshte:

	Per periudhen nga data e themelimit 28 korrik 2017 deri me 31 dhjetor 2017
Te ardhura nga sherbimet e konsulences	17,510,741
Totali	17,510,741

15. Shpenzime te tjera shfrytezimi

Shpenzime te tjera shfrytezimi per periudhen nga data e themelimit 28 korrik 2017 deri me 31 dhjetor 2017 perbehen nga sa me poshte:

	Per periudhen nga data e themelimit 28 korrik 2017 deri me 31 dhjetor 2017
Shpenzime trajnimi	3,473,323
Sherbime konsulence kontabel dhe fiskale	1,263,025
Shpenzime asistence informatike	1,018,004
Shpenzime udhetimi	1,000,321
Shpenzime hotelerie	962,504
Shpenzime dietash	914,448
Shpenzime qiraje	879,444
Shpenzime perfaqesimi	616,835
Shpenzime te tjera	611,606
Shpenzime telefonie	209,483
Shpenzime per sigurimin privat per punonjesit	121,168
Shpenzime bankare	93,414
Shpenzime administrative	89,754
Shpenzime pastrimi	73,080
Shpenzime kancelarie	65,320
Shpenzime interneti	61,874
Shpenzime per sherbime profesionale	42,030
Totali	11,495,633

16. Te ardhura te tjera

Te ardhura te tjera per periudhen nga data e themelimit 28 korrik 2017 deri me 31 dhjetor 2017 perbehet nga sa me poshte:

	Per periudhen nga data e themelimit 28 korrik 2017 deri me 31 dhjetor 2017
Humbje nga kembimet valutore	(108,959)
Fitim nga kembimet valutore	147,664
<i>Fitim neto nga kembimet valutore</i>	38,705
Te ardhura te tjera financiare	25,800
Totali	64,505

Zeri "Te ardhura te tjera" perfshin te ardhurat neto nga kembimet valutore per periudhen nga data e themelimit 28 korrik 2017 deri me 31 dhjetor 2017 dhe gjithashtu te ardhura te krijuara si pasoje e dhuratave te perfituara nga furnitori Vodafone Albania sh.a.

17. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin per periudhen nga data e themelimit 28 korrik 2017 deri me 31 dhjetor 2017 perbehet nga sa me poshte:

	Per periudhen nga data e themelimit 28 korrik 2017 deri me 31 dhjetor 2017
Humbja para tatimit	(10,203,048)
<i>Shpenzime te panjohura</i>	<i>2,066,300</i>
Humbja e tatueshme e vitit	(8,136,748)
Humbje fiskale e mbartur nga vitet e kaluara	-
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	-
Tatim fitimi i parapaguar	-
Tatim fitimi per t'u paguar	-

18. Transaksionet me palet e lidhura

Transaksionet me palet e lidhura per periudhen nga data e themelimit 28 korrik 2017 deri me 31 dhjetor 2017 perbehet nga sa me poshte:

	Per periudhen nga data e themelimit 28 korrik 2017 deri me 31 dhjetor 2017
<i>Te ardhura nga sherbimet e konsulences:</i>	
Alterna S.r.l.	8,873,325
Altea Up S.r.l.	3,896,609
PLM Systems S.r.l.	3,162,882
Altea Digital S.r.l.	2,594,973
Altea 365 S.r.l.	533,180
Totali	19,060,969
<i>Shpenzime per asistence informatike :</i>	
Altea s.p.a.	6,046,794
Altea 365 S.r.l.	2,339
Totali	6,049,133
<i>Shpenzime per trajnimin e stafit:</i>	
Altea Up S.r.l.	3,253,802
Totali	3,253,802
<i>Te arketueshme nga palet e lidhura:</i>	
	Me
	31 dhjetor 2017
Alterna S.r.l.	7,474,316
Altea Up S.r.l.	2,976,883
Altea Digital S.r.l.	1,467,768
PLM Systems S.r.l.	764,463
Altea 365 S.r.l.	531,800
Totali	13,215,230
<i>Te pagueshme ndaj paleve te lidhura:</i>	
	Me
	31 dhjetor 2017
Altea S.p.a.	6,031,144
Altea Up S.r.l.	3,239,460
Altea 365 S.r.l.	2,327
Totali	9,272,931

19. Ngjarje te metejshme

Nuk kane ndodhur ngjarje te tjera te metejshme pas dates se raportimit qe te kerkojne ndryshime apo rregullime te metejshme te pasqyrave financiare.